

L I G J
Nr.7953, datë 21.6.1995

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7638, DATË 19.11.1992 “PËR SHOQËRITË
TREGTARE”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Paragrafi i dytë i nenit 65 të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare” ndryshohet si vijon:

“Janë të detyruara të caktojnë ekspert kontabël të autorizuar të paktën ato shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, të cilat në mbyllje të një ushtrimi financiar tejkalojnë dy nga tre treguesit e mëposhtëm:

- Totali i bilancit 6 milionë lekë.
- Totali i të ardhurave vjetore 12 milionë lekë.
- Numri mesatar vjetor i të punësuarve 10 veta.”

Neni 2

Pas nenit 167 shtohen nenet 167-1, 167-2, 167-3, 167-4, 167-5, 167-6, 167-7 dhe 167-8 me këtë përmbajtje:

- Neni 167.1 “Funksionet e ekspertëve kontabël të autorizuar ushtrohen nga persona fizikë ose nga shoqëri të themeluara ndërmjet tyre në çfarëdo forme qoftë.”

- Në nenin 167.2 “Në shoqëritë e ekspertëve kontabël të autorizuar tri të katërtat e kapitalit themeltar duhet të zotërohen nga ekspertë kontabël të autorizuar. Kur një shoqëri e ekspertëve kontabël të autorizuar ka një pjesëmarrje në kapitalin e një shoqërie tjetër ekspertësh kontabël të autorizuar, aksionarët ose ortakët që nuk janë ekspertë kontabël të autorizuar, nuk mund të zotërojnë më shumë se një të katërtën e tërësisë së kapitalit të të dyja shoqërive.”

- Neni 167.3 “Funksionet e administratorit të kryetarit të këshillit të mbikëqyrjes dhe të drejtorit në një shoqëri të ekspertëve kontabël të autorizuar duhet të kryhen nga ekspertë kontabël të autorizuar. Të paktën tri të katërtat e anëtarëve të organeve të drejtimit, të administrimit, ose të mbikëqyrjes duhet të jenë ekspertë kontabël të autorizuar.”

- Neni 167.4 “Në shoqëritë e ekspertëve kontabël të autorizuar, funksionet e ekspertit kontabël të autorizuar ushtrohen në emër të shoqërisë nga persona fizikë, ortakë ose aksionarë të shoqërisë, që janë ekspertë kontabël të autorizuar.”

- Neni 167.5 “Pranimi në shoqëri i çdo ortaku ose aksionari të ri bëhet me miratimin paraprak që, sipas kushteve të përcaktuar në statut, mund të jepet qoftë nga asambleja e përgjithshme, qoftë nga këshilli i administrimit ose këshilli i mbikëqyrjes apo administratorët e shoqërisë së ekspertëve kontabël të autorizuar.”

- Neni 167.6 “Në rast vdekje të një aksionari a ortaku të shoqërisë së ekspertëve kontabël të autorizuar, trashëgimtarët e tij kanë një afat prej dy vjetësh për t’i shitur aksionet ose pjesët në kapital një eksperti kontabël të autorizuar.”

- Neni 167.7 “Askush nuk mund të ushtrojë funksionet e ekspertit kontabël të autorizuar, në qoftë se nuk është i regjistruar më parë në listën e hartuar për këtë qëllim nga një organizëm profesional i caktuar nga Këshilli i Ministrave.”

Neni 167.8 “Këshilli i Ministrave përcakton organizimin profesional të ekspertit të autorizuar. Ai përcakton sidomos:

1. organizimin profesional, rreth të cilit grupohen ekspertët kontabël të autorizuar dhe rregullat e funksionimit të tij;
2. mënyrën e hartimit dhe të revizionimit të listës së ekspertëve kontabël të autorizuar;
3. kushtet për regjistrimin në listë;
4. regjimin disiplinor që i përket organizimit profesional të ekspertëve kontabël të autorizuar;
5. rregullat e deontologjisë dhe të shpërblimit kontabël të autorizuar.”

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.1142, datë 27.6.1995 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha